



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Seykos” Sh.P.K. të datës 04.09.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Seykos” Sh.P.K. e datës 04.09.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Seykos” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Seykos” Sh.P.K. të datës 04.09.2023 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – “Të nderuar, ju lutem specifikoni kapakun e kontejnerit, në rast se duhet të jetë i rrafshët, apo harkor” .

Pretendimi nr. 2 – “AK ne specifikim teknik, ka paraqitur ngjyren e kontejnerit te jete e zezë - Gri RAL 7021 AT. Ju lutem, na sqaroni ne rast se mund te ofrohet mostra e kontejnerit edhe me ngjyre te gjelbert, per faktin se në ngjyrën e zezë, logoja e Kuvendit Komunal PRISHTINA, nuk theksohet dhe te verehet nejte sic mund te reflektoj në kontejnerin me ngjyre te gjelbert” .

Pretendimi nr. 3 - “Për Artikullin 2, AK ka kerkuar Kontejner Metali, ndër të tjera, në Specifikim Teknik ju si AK keni kerkuar; Body Color Trupi i galvanizuar me kapak Zi/Gri Të nderuar, ju lutem na sqaroni, si keni menduar qe kapaku te jetë i zi.! A duhet që të ngjyroset kapaku me ngjyrë të zezë pas galvanizimit në tërësi të kontejnerit” .

Duhet sqaruar se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kerkuar nga njësia kërkuese që të bëj vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 07.09.2023 njësia kërkuese ka kthyer përgjigjen si në vijim: “1. Kapaku i kontejnereve duhet mund te jete i rrafshët apo harkor. 2. Lidhur me kerkesen per mostra lejohet te jete e gjelbert me specifika sipas kerkeses, kurse ne realizim te kontrates furnizim duhet te jete me ngjyrë të zezë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në tender. 3. Kapaku i kontejnerit të metalit duhet te jete e zezë nga plastika i rrafshët apo harkor” .

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të njësisë kërkuese pasi që sqarimet e tilla janë të plota, të bazuara në LPP dhe RRPP, të mbështetura në dëshmitë dhe dokumentet relevante të aktivitetit të prokurimit.

Duhet sqaruar po ashtu se pretendimet ankimore në formën sikurse janë formuluar nga parashtruesi më shumë ngjasojnë me kërkesa për sqarime shtesë sesa me pretendime ankimore. Megjithatë ato janë trajtuar saktësisht në formën sikurse janë formuluar. Po ashtu duhet cekur se lidhur me kërkesën e parashtruesit për zgjatjen e afatit për dorëzimin e mostrave/ofertave, autoriteti kontraktues tanimë ka pezulluar këtë aktivitet të prokurimit në kuptim të nenit 112 të LPP.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.